

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare kolegji, Enver Peci dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S. nga fshati S. Komuna e S., për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, lidhur me nenin 3 (1.a) të Konventës së katërt të Gjenevës, nenit 152 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 dhe nenit 153 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A.S. av. T.G., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - DKR Ppr.nr.281/2015 datë 07.09.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PN1.nr.1646/2017 të 19 shtator 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.10.2017, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit A.S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Prizren Ppr.nr.281/2015 datë 07.09.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PN1.nr.1646/2017 të 19 shtator 2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - DKR me aktvendimin Ppr.nr.281/2017 datë 07.09.2015, të pandehurit A.S., i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, gjegjësisht deri më datë 08.11.2017, për shkak të veprës penale, krime lufte kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, nenit 152 par.1 dhe 2 par.1.2 dhe nenit 153 lidhur me nenin 31 të KPK-së. Paraburgimi i është vazhduar të pandehurit konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.2 të KPPRK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn1.nr.1646/2017 të 19 shtator 2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit dhe është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A.S., T.G., avokat nga Prishtina për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi kërkesën e mbrojtësit të pandehurit si të bazuar, ta ndryshoi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren - DKR Ppr.nr. 281/2015 dt. 07.09.2017

dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë PN1.nr.1646/2017 datë 19.09.2017, ashtu që klientin e tij A.S. ta liroj nga paraburgimi, apo paraburgimi i vazhduar t`ia zëvendësoj me masa tjera alternative më të buta siç parashihet me dispozitat e nenit 173 të KPPK-së.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.67/2017 datë 04.10.2017, në të cilën propozon që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa e mbrojtësit të pandehurit nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se si Gjykata Themelore në Prizren e po ashtu edhe Gjykata e Apelit në aktvendimet e tyre kanë gjetur se ekziston dyshimi i bazuar se z. A.S., të ketë kryer veprën penale për të cilin janë duke u zhvilluar hetimet edhe pse me asnjë fjalë nuk arsyetohet se si është e mundur që bashkëvendëseve të tij t`ju kujtohet involvimi i tij në veprimet e përshkruara me aktvendimin për zhvillimin e hetimeve, 17 vite pas kinse ngjarjeve ku i pandehuri sipas tyre ka qenë i involvuar. Po ashtu nuk thuhet asnjë fjalë se si është e mundur që i pandehuri të mos jetë etiketuar kurrë nga bashkëvendësit e tij në veprimet për të cilat dyshohet edhe pse i njëjti përmes Aeroportit të Prishtinës shpesh ka ardhur në fshatin e tij në S., ku edhe ka rinovuar shtëpinë e tij të djegur gjatë luftës. Gjithashtu, theksohet se nuk ekziston asnjë arsye për vazhdimin e paraburgimit ndaj tij, kinse ai mund të ndikoi në ndryshimin e provave, duke i asgjësuar apo fshehur ato, duke ndikuar në dëshmitar të cilët nuk janë marrë në pyetje ende nga prokuroria, për faktin se ata nuk i njeh.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e çështjes, procesi penal gjendet në fazën e zhvillimit të hetimeve, ku nga provat e mbledhura gjerë në këtë fazë rezulton se ekziston dyshimi i bazuar si kusht qenësor për vazhdimin e paraburgimit, se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se a do të argumentohen këto fakte, është çështje që do të vlerësohet dhe vërtetohet gjatë fazave të më tutjeshme procedurale. Duhet theksuar se në rastin konkret në këtë çështje penalo-juridike edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate qëndrojnë bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit siç me të drejtë ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, e të cilat vlerësime si të drejta dhe ligjore i pranon edhe kjo gjykatë, ngase të njëjtat në arsyetimin e vendimeve të atakuara kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën iu ka vazhduar paraburgimi të pandehurit konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.2 të KPPK-së.

Andaj, duke marrë parasysh peshën e rëndë të kësaj vepre penale, mënyrën e kryerjes së saj (dyshimin e bazuar se i pandehuri në bashkëveprim me pjesëtarët e forcave të armatosura serbe

ka plagosur, rrahur, plaçkitur, dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre për të shkuar në Shqipëri), se i pandehuri është shtetas i shtetit të Gjermanisë, se deri në ditën e arrestimit ka qenë i paarritshëm për organet e drejtësisë, pastaj dënimi që i kanoset, janë arsye të mjaftueshme për të justifikuar frikën se me gjetjen e tij në liri apo nënë ndonjë masë më të butë për sigurimin e prezencës së tij në procedurë do të jetë prapë vështirë i arritshëm për organet e ndjekjes, për çka qëndron baza për vazhdimin e mëtutjeshëm të paraburgimit nga dispozita e nenit 187 par.1 nënëpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të KPPK-së.

Qëndron po ashtu baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit A., sipas nenit 187 par.1 nënëpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse siç rezulton nga shkresat e çështjes me gjetjen e të pandehurit duke u mbrojtur në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale duke ndikuar në dëshmitarët - të dëmtuarit të cilët janë bashkëfshatarët e tij të cilët nuk janë dëgjuar nga ana e prokurorisë, po ashtu ekziston rreziku real po qese i pandehuri lihet për t'u mbrojtur në liri, do të pengoj rrjedhën normale të procedurës penale.

Nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit kur theksohet se me asnjë fjalë nuk arsyetohet në vendimet e atakuara se si është e mundur që bashkëvendëseve të tij t'ju kujtohet involvimi i tij në veprimet e përshkruara me aktvendimin për zhvillimin e hetimeve, 17 vite pas kinse ngjarjeve të luftës, për faktin se siç rezulton nga shkresat e çështjes disa nga dëshmitarët e familjes E. etj., ende i kanë të freskëta dhe i përshkruajnë vuajtjet dhe maltretimet që i janë bërë nga i pandehuri në bashkëveprim me forcat ushtarake - policore serbe. Nga dëshmitë e deponuara para organeve të ndjekjes, ndër të tjera është theksuar se identifikimi i të pandehurit nuk ka qenë i vështirë pasi që i njëjti ka punuar në Sekretariatit e Punëve të Brendshëm të atëhershëm si zyrtar për dhënien e pasaportave.

Rrjedhimisht, nga arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.276/2017, më 09.10.2017

B.profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa